



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN-OGRAK LIPLJAN

**P.nr.747/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN**, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të akuzuarit I.D. nga fsh. M. K. L, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.8316/2014 të dt.31.10.2016, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me dt.13.03.2017, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit Blerim Igrishta, dhe të akuzuarit, në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpall këtë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të akuzuarit:

**I.D.**, nga i ati F., i lindur më dt. *data e lindjes...*, në fshatin M. K. L, me nr. personal *numer personal...*, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse:**

Me datën 13.11.2014, rreth orës 15:15, në udhëkryqin e S. në magjistralen Prishtinë-Shtime, i pandehuri I.D. derisa ka qenë duke drejtuar automjetin e tipit “V.” me targa të regjistrimit *targa te regjistrimit...*, ka shkelur Ligjin mbi Trafikun Publik dhe ka rrezikuar jetën e njerëzve, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 13 dhe nenin 62.1 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, me të arritur nuk ka respektuar shenjën Stop, dhe nuk ka respektuar të drejtën e përparësisë së kalimit pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion, me ç’rast në pjesën anësore goditet nga automjeti i tipit “M B” me targa të regjistrimit *targa te regjistrimit...*, i cili ka pas përparësinë e kalimit, me ç’rast përveç dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin pësojnë B.D, L.D, dhe J.D.

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 23, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 73, 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së të pandehurin e gjykon me,

**DËNIM ME KUSHT**

Me dënim me gjobë në shumë prej **300-€ (treqindëeuro)**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Të dëmtuarat, B.D, L.D., dhe J.D., udhëzohen që kërkesën pasurore-juridike ta realizojnë në procedurë të rregullt gjyqësore.

**DETYROHET** i akuzuari në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajë, shumën prej 90.88-€, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor shumën prej 20-€, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj, PP.II.nr.8316/2014 të dt.31.10.2016 e ka akuzuar të pandehurin i.D, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar, ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues, dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili është bërë konform dispozitave ligjore dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe nga gjykata ka kërkuar që me rastin e matjes së dënimit, të njëjtit ti shqiptohet një dënim sa më i butë, ngase i njëjti është mbajtës i familjes, dhe njëherit ka shtuar se kjo vepër ka ndodhur nga pakujdesia, dhe të dëmtuarit janë të familjes time.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të pandehurit, për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se i pandehuri është mbajtës i familjes, sjelljen e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor, veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2, pika 2.1 dhe pika 2.6 të KPPK-së.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.**

**P.nr. 747/16 dt. 13.03.2017**

**Sekretarja juridike**  
**Nexhmije Ahmeti**

**GJYQTARI**  
**Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.